



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 11.06.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11,13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 9,10 dhe 33 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve, si dhe Përfundimit nr.06-35073 -4/1 të miratuar në Mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur me dt: 22.05.2015, me të cilin është miratuar kërkesa e përbashkët e Mezijet dhe Argjente Shehu nga Gjakova, për mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrjen e nxënësve Pëllumb Doli dhe Galina Shehu në Festivalin Ndërkombëtarë të Fëmijëve në Gjeorgji, në cilësi të përfaqësuesve të Gjakovës dhe të Kosovës, me dt: 11.06.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1.Miratohet kërkesa e përbashkët e parashtruar nga Mezijet Shehu dhe Argjente Shehu nga Gjakova, e evidentuar me nr. 01-400-33395 e dt:15.05.2015 për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit në Gjeorgji, për përcjelljen dhe pjesëmarrjen e nxënësve Pëllumb Doli dhe Galina Shehu në Festivalin Ndërkombëtarë të Fëmijëve për Kulturë, Stil, dhe Arte, i cili mbahet në Gjeorgji nga dt: 01-06 Qershor 2015, duke e mbështetur këtë kërkesë me mjete financiare në vlerë prej 800€ nga linja e subvencioneve të Zyrës së Kryetares të Komunës .

2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 800 €, nga pozicioni i subvencioneve të Zyrës së Kryetares të Komunës së Gjakovës dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë e znj. Argjente Shehu nga Gjakova nr. 2018000006976706 – Teb Bank , e cila është person i autorizuar për përcjelljen e nxënësve Pëllumb Doli dhe Galina Shehu në shtetin e Gjeorgjisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

4. Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- Znj. Argjente Shehu nga Gjakova, rr. “Mihajl Grameno” nr.16
- Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj.Mimoza Kusari- Lila